

**DEKRET**  
**Nr.6070, datë 24.2.2009**

**PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE**

Në mbështetje të neneve 92 shkronja “g” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 11 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Akademik Gudar Beqiraj, emërohet në detyrën e Kryetarit të Akademisë së Shkencave.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**